

Numri i lëndës: 2022:172779

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05500660

CP.nr.28/2024

GJYKATA THEMELORE NË G. - DEGA NË VITI, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, sipas gjyqtarit Raif Fazliu, duke vendosur në lëndën përbarimore të kreditorit, B.B. nga fshati D. Komuna e V., të cilin e përfaqëson me autorizim S.M.avokate në G., duke vendosur sipas prapësimit të debitores, Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A. (KEDS) me seli në Prishtinë, Bulevardi “Bill Klinton” nr.5, kundër Aktvendimit për lejimin e përbarimit CP.nr.489/2022, i datës 01.09.2022, të nxjerr nga Gjykata Themelore në G. - Dega e V., për lejimin e përbarimit të Aktgjykimit C.nr.2869/16, i nxjerr nga Gjykata Themelore në Prishtinë me 22.07.2019, ndërsa i ekzekutueshëm me datë 06.06.2022, për kompensimin e të ardhurave personale, vlera e kompensimit 15,895.30 €, duke vendosur jashtë seancës gjyqësore me datë 25.03.2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET i pa bazuar prapësimi i debitores Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A.(KEDS) me seli në Prishtinë, kundër lejimit të përbarimit të Aktvendimit CP.nr.489/2022, i datës 01.09.2022, të dhënë nga Gjykata Themelore në G. Dega në Viti, për bartjen e mjeteve financiare nga kontoja bankare e debitores, në llogarinë e të autorizuares së kreditorit, deri në vlerën e borxhit kryesor, duke i përfshirë edhe kontributet pensionale si dhe në emër të tatimit në shumën e përgjithshme prej 15,895.30 €.

II. Mbetet në fuqi Aktvendimi për lejimin e propozimit i nxjerr nga Gjykata Themelore G.-Dega e V., me nr. CP.489/2022, i datës 01.09.2022 .

III. Detyrohet debitorja Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) me seli në Prishtinë, që kreditorit B.B. nga D.i i V., t’ia kompensojë lartësinë e shpenzimeve kontestimore në shumën prej 713.60 euro dhe kompensimin të shpenzimeve të procedurës përbarimore në vlerë prej 156 €, për hartimin e propozimit për përbarim, sipas tarifave të OAK-ës, dhe atë në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në G. - Dega e V. me Aktvendimin CP.nr.489/2022, të datës 01.09.2022, ka lejuar përbarimin sipas propozimit të kreditorit B.B. nga fshati D. i V., kundër debitorit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A. (KEDS) me seli në Prishtinë, duke detyruar debitorin që në emër të pagesës së kompensimit të ardhurave personale t’ia paguajë kreditorit dyfishin e pagave mujore dhe atë në emër të pagave neto 14,660.78 €, në emër të kontributit pesonal 793.10 €, si dhe në emër të tatimit të paguaj shumën prej 441.42 €, me kamatë vjetore prej 8 %, duke filluar nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi

deri në pagesën definitive t'ia kompesojë kreditorit shumën totale prej 15,895.30 € dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në vlerën prej 713.60 €, sikur edhe të procedurës përmbartimore në lartësi prej 156 euro, për përpilimin e propozimit për lejimin e përmbartimit, sipas Tarifave të Odës së Avokatëve të Kosovës (TOAK-ës), duke i bartur mjetet nga kontoja bankare e debitorës, në llogarinë e të autorizuarës së kreditorit avokates Sadbere Maliqi, në xhirollogarinë 13-02-0010014438.96, në Bankën Private për Biznes dhe atë në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të aktvendimit, nën pasojën e përmbartimit të dhunshëm.

Të gjitha këto të bazuara në Aktgjykimin C.nr.2869/16, i nxjerr nga Gjykata Themelore në Prishtinë, i nxjerr me datë 22.07.2019, i plotfuqishëm me 04.05.2022, ndërsa i ekzekutueshëm me datë 06.06.2022. Plotfuqishmërinë ky Aktgjykim e kishte arritur përmes Aktgjykimit Ac.nr.1422/20 i nxjerr me datë 22.07.2019, nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me të cilin ishte vërtetuar aktgjykimi paraprak i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Pasi kjo gjykatë kishte lejuar përmbartimi e propozuar nga ana e kreditorit me Aktvendimin E.nr.489/2022, datë 01.09.2022, debitori Keds, kishte ushtruar prapësim kundër këtij Aktvendimi, të cilin prapësim Gjykata e kishte refuzuar me Aktvendimin e datës 28.10.2022. Ndaj këtij Aktvendimi debitori ka ushtruar ankesë, e cila ankesë në përmbajtje i përmban arsyet sikur të ishte ushtruar kundër vendimit në procedurën kontestimore, Gjykata e Apelit e Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, me Aktvendimin CAP.nr.233/23, datë 21.02.2024, pasi e pranon si të themeltë ankesën e debitorit, e anulon Aktvendimin CP.nr.489/22, datë 28.10.2022, të Gjykatës Themelore në G. - Dega në Viti dhe lëndën e kthenë në shkallë të parë në procedim të sërishëm.

Kjo gjykatë duke vepruar sipas udhëzimeve të dhëna nga Gjykata e Apelit, respektivisht pasi kreditori personalisht në gjykatë kishte dorëzuar Aktgjykimet në origjinal (neni 36.1 i LPP-së), Aktgjykimin C.nr.2869/16, i nxjerr nga Gjykata Themelore në Prishtinë, i nxjerr me datë 22.07.2019, i plotfuqishëm me 04.05.2022, ndërsa i ekzekutueshëm me datë 06.06.2022 dhe Aktgjykimin Ac.nr.1422/20 i nxjerr me datë 22.07.2019, nga Gjykata e Apelit e Kosovës, ashtu që ka plotësuar dhe rregulluar urdhrin për përmbartim sipas nenit 24 dhe 36 të LPP-së, gjykata jashtë seancës konstaton:

Debitorja me datën 07.09.2022, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim kundër aktvendimit të kësaj Gjykate. Në prapësim debitorja ka theksuar: se Propozimi për përmbartim është i lejuar tani në bazët të dokumentit përmbartimor dhe atë nga Gjykata e shkallës së parë dhe të dytë, duke caktuar përmbartimin në emër të kreditorit B.B. nga fshati D. i V., shumën e përmbartimit prej 14.660.78 euro, duke ja bashkangjitur edhe në emër të trustit pensional shumën prej 793.01 euro dhe në emër të tatimit prej 441.42 euro, me kamat ligjore prej 8%, si dhe shumën prej 713.06 euro në emër të shpenzimeve gjyqësore në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

Debitori në prapësim ka theksuar se dokumenti i praqitur nuk përmban tipare të përmbartueshmërisë në kuptim të nenit 71 të LPP-ës, pasi që është lëshuar me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale, njëkohsisht ka shkelur dispozitat e procedurës kontestimore dhe gabimisht është vërtetuar gjendja faktike, me arsyetim se me datën 10.06.2022, debitori ka ushtruar Revizion pranë Gjykatës Supreme të Kosovës kundër aktgjykimit të shkallës së parë dhe të dytë me shenjat nr. C.2869/2016 dhe Ac.1422/2020. Debitori i kishte kërkuar shpenzimet për përmbartim, andaj kishte kërkuar nga Gjykata që të aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar dhe të anulohet Aktvendimi CP.nr.489/2022, i datës 01.09.2022, të dhënë nga Gjykata Themelore në G. - Dega në Viti.

Përfaqësuesja e kreditorit Sadbere Maliqi, pas pranimit të prapsimit me datën 22.09.2022, ka ushtruar përgjigje lidhur me prapsimin e debitorës, ashtu siç është përcaktuar në nenin 72 paragrafi 3 të LPP-ës, duke e kundërshtur prapësimin e debitorës, me arsyetim se nuk ka arsye që të aprovohet prapësimi pasi që aktvendimi i lejuar nuk është përfshirë me shkelje thelbore të dispozitave të procedurës kontestimore e përmbartimore dhe faktin se tani ky dokument përmbartimore është i plotfuqishëm dhe i përmbartueshëm, dhe se sa i përket pretendimit të debitorës se paraqitja e revizionit e ndalon përmbartimin është e pa bazuar dhe se nuk e ndërprente përmbartimin, i kishte kërkuar shpenzimet për përpilimin e kësaj përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, konstatoi se prapësimi si i tillë është i pa bazuar, me arsyetim se Propozimi për përmbartim i lejuar nga kjo Gjykatë, i bazuar sipas dokumentit përmbartues Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2869/2016, i datës 22.07.2019, i plotfuqishëm me datë 04.05.2022 dhe i ekzekutueshëm me datë 06.06.2022 dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Ac.nr.1422/2020 i datës 04.05.2022, i vërtetuar si i tillë paraqet dokument të përmbartues konform nenit 22 të LPP-ës, dhe se gjykata nuk mund të lëshohet në ligjshmerine e një vendimi të formës së prerë, pasi që në Procedurën Përmbartimore vlenë parimi i rigorizitetit formal, që nënkupton se gjykata në Procedurën Përmbartimore nuk guxon të lëshohet në ligjshmerine e vendimit të formës së prerë, respektivisht të vërtetohet edhe njëherë gjendjen faktike, e cila tanimë është vërtetuar në shkallë të parë nga Gjykata Themelore e Prishtinës me Aktgjykimin C.nr.2869/16, e të cilin e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit me Aktgjykimin Ac.nr.1422/20 me datë 04.05.2022.

Po ashtu konform nenit 213 LPK-ës gjykata nuk mund ta pezulloj procedurën përmbartimore, për shkat të ushtrimit të revizionit nga ana e debitorit, pasi që sipas nenit të cekur *“Revizioni i paraqitur nuk është pengesë për përmbartimin e aktgjykimit të formës së prerë”* me të cilin vendim është bazuar propozimi sipas dokumentit përmbartues.

Në fund gjykata konstaton se debitori me asnjë provë relevante të paraparë me nenin 69. paragrafi 4. të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, nuk e ka bazuar në asnjërin nga shkaqet e prapësimin të parapara me nenin 71, të të njëjtit ligj. Gjykata vendosi konform dispozitave ligjore të nenit 17, 22, 24, 27, 36, 69 dhe 71, LPP-ës dhe 13 të LPP-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË G. – DEGA NË VITI
CP.nr. 28/2024 më; 25.03.2024.

Gj y q t a r i
Raif Fazliu

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

